



VENDIM

Nr. 246, datë 21.12.2016

PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË “RREGULLOREN PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR RENDITJEN E SHËRBIMEVE AUDIO DHE/OSE AUDIOVIZIVE QË MBËSHTETEN NË RRJETE NUMERIKE”, MIRATUAR ME VENDIMIN E AMA-S, NR. 218, DATË 12.10.2016

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1/ë dhe 16 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Autoriteti i Mediave Audiovizive,

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimeve dhe shtesave në “Rregulloren për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për renditjen e shërbimeve audio dhe/ose audiovizive që mbështeten në rrjete numerike”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 218, datë 12.10.2016, si më poshtë:

1.1 Në gërmën “e” të pikës 1 të nenit 8 shtohet fjalia: “Ky parim nuk zbatohet për shërbimet programore të operatorëve rajonalë të licencuara me afat deri në mbylljen e transmetimeve analoge”.

1.2 Pas nenit 8, shtohet neni 8/1, me këtë përmbajtje:

“1. Caktimi i NLP-së së shërbimeve programore kombëtare të përgjithshme bëhet në përputhje me renditjen e rezultuar nga matja e audiencës audiovizive.

2. Shërbimet programore kombëtare të përgjithshme të operatorëve analogë privatë kombëtarë të licencuar nëpërmjet procedurës “beauty contest” kanë përparësi ndaj programeve të operatorëve kombëtarë private të licencuar sipas procedurës së licencimit të rrjeteve numerike. Ndërmjet operatorëve privatë kombëtare të licencuar sipas procedurës “beauty contest” kanë përparësi shërbimet programore kombëtare të licencuar sipas ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”. Shërbimet programore kombëtare të përgjithshme, deri në përfundim të matjes së audiencës audiovizive, do të pajisen me NLP të përkohshme, të vlefshme deri në datën 31 dhjetor 2017.

3. Caktimi i NLP-së së shërbimeve programore kombëtare të përgjithshme do të bëhet me short, sipas procedurës së parashikuar në këtë rregullore.”

1.3 Pas nenit 10, shtohet neni 10/1, me këtë përmbajtje:

"1. Caktimi i NLP-së së shërbimeve programore private rajonale dhe lokale bëhet në përputhje me renditjen e rezultuar nga matja e audiencës audiovizive.

2. Shërbimet programore private rajonale dhe lokale, deri në përfundim të matjes së audiencës audiovizive, do të pajisen me NLP të përkohshme, të vlefshme deri në datën 31 dhjetor 2018, sipas procedurës së parashikuar në këtë rregullore."

2. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:

Gentian

SALA

Zëvendëskryetar:

Sami

NEZAJ

Anëtarë:

Agron

GJEKMARKAJ

Gledis

GJIPALI

Piro

MISHA

Suela

MUSTA

Zylyftar

BREGU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 243, DATË 21.12.2016

**PËR
MOSRINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË "SCORPION" SH.P.K., LICENCUAR PËR
SUBJEKTIN RADIOFONIK PRIVAT VENDOR "RADIO MARIA"**

Autoriteti i Mediave Audiovizive, i përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Sami	Nezaj	Zëvendëskryetar
Agron	Gjekmarkaj	Anëtar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Piro	Misha	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar
Zylyftar	Bregu	Anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen që i përket palëve:

Kërkues: Shoqëria "Scorpion" sh.p.k.

Objekt: Mosrinovimin e licencës së shoqërisë "Scorpion" sh.p.k., licencuar për subjektin radiofonik privat vendor "Radio Maria".

Baza Ligjore: Neni 19, pika 16 dhe neni 68, pikat "a" dhe "b" të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar,

VËREN

KKRT, me vendimin nr. 29/23, datë 30.10.2000 ka licencuar shoqërinë "Scorpion" sh.p.k., për radio lokale FM private. Me vendimin nr. 247 datë 21.06.2004, KKRT miratoi ndryshimin e zonës së licencimit të subjektit duke e autorizuar të mbulojë me sinjal radiofonik Prefekturën Tiranë dhe Durrës, rrethin Shkodër dhe Lezhë. Me vendimin nr. 99 datë 03.04.2013 KKRT rinovoi licencën e subjektit radiofonik privat vendor "Radio Maria" për një periudhë 3-vjeçare. Afati i vlefshmërisë së licencës së subjektit ka përfunduar në datën 03.01.2016.

Përpara përfundimit të afatit të vlefshmërisë së licencës, shoqëria "Scorpion" sh.p.k., ka depozituar aplikimin nr. 2686 prot., datë 22.12.2015, për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor "Radio Maria".

Në përputhje me ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Aktin e Brendshëm "Mbi procedurat e rinovimit të licencave të operatorëve privatë audio dhe audiovizivë, të licencuar sipas ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar", miratuar me vendimin nr. 2, datë 04.02.2015 të AMA-s, në datën 06.01.2016 u mblodh Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit (KSHD) për të shqyrtuar aplikimin e depozituar nga subjekti.

Nga shqyrtimi i përmbajtjeve të transmetuara prej këtij subjekti, rezulton se natyra e programacionit dhe linja editoriale e subjektit radiofonik "Radio Maria" është e orientuar vetëm tek besimi katolik.

Nga ana tjetër, AMA me vendimin nr. 55, datë 04.04.2016 ka miratuar rregulloren "Për dhënien e licencave të transmetimit audio të komunitetit". Pas miratimit të këtij akti nënligjor, AMA me shkresën nr. 1520 prot., datë 20.05.2016, ka kërkuar nga shoqëria "Scorpion" sh.p.k., të deklarojë interesin e tij mbi vijimin e veprimtarisë audiovizive, nëse do të vijoje ushtrimin e veprimtarisë si subjekt me program gjeneralist apo si shërbim transmetimi audio komunitar.

Në përgjigje të shkresës sonë, shoqëria "Scorpion" sh.p.k., me shkresën nr. 1520/1 prot., datë 19.07.2016, ka kthyer përgjigje duke bërë me dije se:

"...shoqëria "Scorpion" sh.p.k., zotërohet në masën 98% të kuotave nga "Shoqata Radio Maria", organizatë jofitimprurëse e regjistruar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Si e tillë, "Shoqata Radio Maria" ka formën e duhur ligjore për të patur licencë audio komunitare. Gjithashtu, shoqata... ka të gjithë infrastrukturën e duhur teknike dhe soliditet financiar, prandaj shprehim interesin tonë që të pajisemi me licencë audio komunitare dhe do t'i nënshtrohemi të gjithë procedurave ligjore, në mënyrë që licenca e shoqërisë "Scorpion" sh.p.k., për të gjithë zonat e mbulimit, t'i kalojë subjektit "Shoqata Radio Maria", si licencë audio komunitare..."

Duke qenë se subjekti gjatë zhvillimit të procedimit administrativ për shqyrtimin e aplikimit ka deklaruar se kërkon të ndryshojë natyrën e shërbimit audio që ofron në treg, AMA vlerëson se duhet të shprehet për mosrinovimin e licencës së shoqërisë "Scorpion" sh.p.k., për subjektin radiofonik privat vendor "Radio Maria".

Neni 68 i ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar parashikon: "Licenca dhe/ose autorizimi bëhet e pavlefshme kur: a) mbaron afati i vlefshmërisë dhe ajo nuk është rinovuar; b) i licencuari ose i autorizuari njofton me shkrim AMA-n për mbylljen e aktivitetit."

PËR KËTO ARSYE

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në mbështetje të nenit 19, pika 16 dhe nenit 68, pikat "a" dhe "b" të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Mosrinovimin e licencës së shoqërisë "Scorpion" sh.p.k., licencuar për subjektin radiofonik privat vendor "Radio Maria".
2. Konstatimin e pavlefshmërisë së licencës së shoqërisë "Scorpion" sh.p.k., licencuar për subjektin radiofonik privat vendor "Radio Maria".
3. Ngarkohet administrata e AMA-s për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë sipas legjislacionit në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:	Gentian	SALA
Zëvendëskryetar:	Sami	NEZAJ
Anëtarë:	Agron	GJEKMARKAJ
	Gledis	GJIPALI
	Piro	MISHA
	Suela	MUSTA
	Zylyftar	BREGU